REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 662/22
Date/Datum. 12.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Faruk Rexhepi	*21.11.2022*	*12.12.2022*	662/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.11.2022, OE N.P.SH. "ESG" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 662/22, ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: **Vlera e parashikuar është 294,100.00 €.**

- Data njoftimi për kontratë: 22.07.2022
- Afati për dorëzimin e ofertave: 01.09.2022
- Procesverbali i hapjes se ofertave: 01.09.2022
- Raporti i Vlerësimit : 10.10.2022
- Njoftimi mbi Vendimin e AK-se dhe Letrat Standarde 27.10.2022
- Kërkesa për Rishqyrtim 01.11.2022
- Vendimi i autoritetit kontraktues, refuzimi i kërkesës për rishshqyrtim 07.11.2022
- Ankesa ne OSHP 15.11.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1, 6, 7, 59, 69, 72 i LPP

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

"ESG" N.P.SH
Numri Unik Identifikues:
811381602
Email:
esg.npsh@gmail.com

Ankesë kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të AK

Fillimisht ankimimin tonë e kemi bazuar në 3 pika kryesore si të gjetura të OE të shpallur fitues nga AK.

Ne si OE nuk pajtohemi me vendimin e AK për 2 pika. Per 1 pikë të ankimimit jemi pajtuar.

Përshtatshmëria profesionale:

1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik ne regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës ne vendin e juaj të themelimit ose (ARBK).

Dëshmi: 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit me shifrën e veprimtarisë përkatëse (kopje), për Kompanitë e huaja, në rast të shpërblimit me kontratë, duhet të regjistrojnë biznesin (përfaqësinë) e tyre ne Kosovë.

Kapacitet teknik dhe profesional:

2. Operatori ekonomik duhet të plotësoj kriteret e veçanta ne përpathje me nenin 10 te Ligjit për Shërbime Keshillimore 04/L074.

Dëshmi 2: 1. Personi juridik që ofron shërbime Këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të financuara nga fondet publike apo fondet ndërkombëtare, duhet të 1.1. posedoj lejen e punës; dhe 1.2. të jetë i regjistruar ne regjistrin e ndërmarjeve për shërbime këshilluese per bujqësi dhe zhvillim rural ne Ministri. 2. Personi juridik sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet plotësoj kriteret si në vijim 2.1. të ketë te punësuar së paku dy (2) këshilltarë për bujqesi dhe zhvillim rural që posedojnë certifikata valide sipas nenit 17. të këtij ligji; 2.2 të ketë hapësirë dhe pajisje të nevojshme për veprimtarinë këshilluese; 2.3. të ketë licencën për ushtrimin e veprimtarisë të shërbimeve këshilluese te lëshuar nga Ministria. 3. Personi juridik që ofron shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të cilat nuk janë të ndërlidhura me fondet publike dhe ndërkombëtare, duhet te regjistrohet në Regjistrin e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

3. Operatori ekonomik duhet te ketë staf të mjafueshëm për zbatimin e projektit ku përveç ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi inxhinier te diplomuar me këto profile 1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore 2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale 3. Ekspertë i penetarisë- vreshtarisë

Dëshmi 3: Dëshmi Kontrate pune valide ose marrëveshje për ketë projekt, Diploma e fakultetit te Bujqësisë 4 vjeçar ose ekuivalent me master, CV, letër rekomandimi ose referenca për punën e mëparshme kopje

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH. ESG - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese"** me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

"ESG" N.P.SH
Numri Unik Identifikues:
811381593
Emaili
esg.ngsh@gmail.com

Arsyetim nga AK për refuzim të kërkesës për shqyrtim

Përgjigje nga AK për pikën I.

Andaj ne po themi se kemi vepruar ne baze te rekomandimit te KRPP MI-REH-RI-NCT-DRR-19-10-2-5-2022 kemi kerkuar interpretime keshilla lidhur me kete dhe na kane ofruar kete interpretim me tekst kesaj qeshje duke na udhezuar te veprojme sipas Nenit 4 paragrafi 1.33 i LPP se perkaktoni se:

"Operator Ekonomik – nenkuptohem qe perfshine furnizuesin, ofruesin e sherbimeve dhe/ose kontraktuesin e punes. Per qellim te kesij ligji, edhe organizatat e shoqerise civile konsiderohen operator ekonomik".

Si i perkate regjistrimit te OJQ se me rregullore te UNMIK ne Ligji me nr.03/L-134 nem 26 OJQ te e regjistruara sipas Rregullores se UNMIK 1999/22

"Cdo OJQ e regjistruar sipas Rregullores se UNMIK ne nr.1999/22 per Regjistrimin dhe Veprimtarine e Organizatave Joqeveritare ne Kosove konsiderohet e regjistruar ne Kosove sipas kesij ligji"

Po ashtu Ligji me NR.04/L-057 neni 26 OJQ te e regjistruara sipas Ligjit 03/L-134 per Lirine e Asocimit ne OJQ ne Kosove.

Theme se cdo OJQ e regjistruar sipas Ligjit 03/L-134 per Lirine e Asocimit ne OJQ ne Kosove konsiderohet e regjistruar ne Kosove sipas kesij ligji.

Ligji me nr.06/L-043 Neni 47 OJQ te e regjistruara ne Kosove 1. Cdo OJQ e regjistruar ne baze te Ligjit Nr.04/L-057 per Lirine e Asocimit ne Organizatat Joqeveritare konsiderohet e regjistruar ne Kosove sipas kesij Ligji.

Përgjigje nga AK për pikën II.

Ne baze te LPP nem 66 ka mundesuar qe O.E. KDC & GLV – Ojeraxica te i kerkojne sqirime shtese per licencen e ushtrimit te veprimtarise keshilluese te leshuar nga MBPZHR / DSHKI-se, e ngritur ne sistemin e prokurimit me dt.22.09.2022.

E cila eshte plotesuar permes sistemit te prokurimit me dt. 22.09.2022 ne ora 6:39 nga O.E. Grupi i Operatoreve Ekonomik OJQ KDC Gj: GLV Ojeraxica. E cila eshte plotesuar me LRLNCT me numer 1741.00b.

Përgjigje nga AK për pikën III.

Operatori ekonomik duhet te kete staf te rapaluneshem per zbatimin e projektit ku perfshe ekspertet e qe do te angazhohen gjate zbatimit te projektit duhet te kete tre (3) ekspert per Agronomi inxhinier te diplomuar me keto profile 1. Ekspert i prodhimtarise bimore 2. Ekspert i prodhimarise blegtorale 3. Ekspert i pemcitarise-vreshtarise.

Ne baze te DT III.2.4) Kapacitet teknik dhe profesional: Pika 2 si deshmi kerkohet: 2.

- Kontrate pune valide ose marreveshje per kete projekt,
- Diploma e fakultetit te Bujqesise I vjeter ose ekuivalent me master,
- CV,
- leter rekomandimi ose referenca per punen e meparshme kopie

1. Ekspert i prodhimrarise blegtorale sipas ekzaminimit dhe vleresimit pleresohet me ekspert te kenij profil me 2 Vjet Kasnmaj i cili ka certifikate nga Universiteti i Kosovës "Fakulteti i

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

Bujqesisë" me nr.3/1353/79 dt.23.01.1986, sesioni i pergjithshem dhe eshte Inshinier i diplomuar i Bujqesise cila vërtetohet nga U.K se mund te perdoret ne vend te diplomes.
Sipas deshmive te kerkuara plotesohet me Kontrate, CV, dhe provojen e deshmuar me referenca te cilat jane DT dhe jo te specifikuara sic; pretendoni.

Po ashtu Grup i Operatoreve Ekonomik OJQ KDC GJ; GLV Gjeravica ka ofruar edhe nje ekspert tjeter z: Fehmi Salihu si ekspert i prodhimtarise bleghtorale qe eshte i listuar ne listen e stafit me Diplome, kontrate, cv dhe reference.

Eksperte i pemetarise- vreshtarise plotesohet me ekspertin z. Reshep Ahaj i cili posedon diplome po ashtu Letter reference nga KDC ku angazhimi i tij ka qene sipas planit dinamik rreth ngritjes se kapaciteteve për fermer dhe shoqata te fermerëve.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Në bazë të të gjeturave kemi konstatuar dhe kemi vendosur për kërkesë për rishqyrtim ndaj OE-Konsorciumit të suksesshëm në pikën 7.1&7.2 për përshtatshmërinë profesionale, pikën 9.1 & 9.2 të FDT për kapaciteti teknik dhe professional, pasi që mendojmë që OE nuk i ka plotësuar këto kritere të përcaktuara në FDT.

I. Në bazë të dokumentacionit të cilën e kemi siguruar, Operatorëve Ekonomik **i mungon Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial** dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit ose (ARBK). Ku si dëshmi OE është dashur që të dorëzojë Certifikatën e regjistrimit të biznesit - **me shifrën e veprimtarisë përkatëse (kopje)**, për Kompanitë e huaja, në rast të shpërblimit me kontratë, duhet të regjistrojnë biznesin (përfaqësinë) e tyre në Kosovë.

- OE Gjeravica ka dorëzuar Certifikatën e Regjistrimit të OJQ-ve, që bjn Organizatë Joqeveritare është regjistruar në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-134, Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

- Operatori Ekonomik KDC Gj. ka dorëzuar një dokument që shkruan "NGO Registration Certificate" që në bazë të përkthimit i bie që është "Certifikatë e Regjistrimit OJQ", e cila organizatë, shkruan që është regjistruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/22. Gjithashtu, për hamendje të gjitha kontratat e punëtorëve janë të lidhura në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/22, e cila i përjashton ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës.

Fillimisht, ne si Operator Ekonomik ndihemi të diskriminuar pasi që sipas letrës standarde përfitues i kontratës është ky grup i operatorëve ekonomik i cili funksionon si OJQ dhe më e keqja ende me rregullore të UNMIK-ut e cila rregullore më nuk ekziston. Nuk mund të barazohet OJQ me Biznesin dhe nuk mund të jenë të njëjta përderisa OJQ në bazë të Ligjit Nr. 03/L-134, Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare janë organizata jo fitumprurëse (jo profitabile) dhe përderisa janë jo-fitumprurëse dhe nuk kanë fitime atëherë edhe nuk paguajnë tatim në fitim, në bazë të ligjeve në fuqi.

Sipas përshtatshmërisë profesionale OE duhet dashur që të dorëzojnë si dëshmi "**Certifikatë e regjistrimit të biznesit-me shifrën e veprimtarisë përkatëse** (kopje), per Kompanitë e huaja, ne rast të shpërblimit me kontrate, duhet te regjistrojne biznesin (perfaqësimë) e tyre ne Kosovë".

Me kërkesë të shifrës së veprimtarisë përkatëse, AK e ka eliminuar të drejtën e aplikimit të OJQ-ve pasi që OJQ-të nuk posedojnë shifër të veprimtarisë. Se e shihni edhe nese aplikon ndonje kompani e huaja, duhet gjithsesi ta regjistroj biznesin e tyre në Kosovë me shifrën e veprimtarise perkatëse te cilën OJQ te mak e posedojnë.

Pavarësisht qe pergjigja e AK ishte ne interpretimin e KRPP per Definicionin e Operatorit Ekonomik, qe ne pajtohemi qe ne kuadër të definicionit bynë edhe OJQ si Operator Ekonomik. **Mirëpo, AK te "Përshtatshmëria Profesionale" nuk e ka definuar që mund të marrin pjesë edhe OJQ duke qenë deciduv që OE duhet të dorëzojë Certifikatën e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit ose (ARBK). Ndërsa, si dëshmi OE duhet të ketë Certifikatën e regjistrimit të biznesit-me shifrën e veprimtarisë përkatëse (kopje), për Kompanitë e huaja, në rast të shpërblimit me kontratë, duhet të regjistrojnë biznesin (përfaqësimë) e tyre në Kosovë. Kjo është në kundërshtim me Nenin 59, pika 4 të LPP ku thotë:** "Autoriteti kontraktues do të konsideroje një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përpothshtëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse ai përmban vetëm gabime ose paqartesi ti cilat mund te korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime te vogla që nuk mund të shkaktojne ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tyra të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit; me kushtë që, efarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Sa i përket Certifikatës së OJQ të lëshuar nga UNMIK-ku ne kemi kërkuar mendim nga Departamenti i OJQ-ve në kuadër Ministrisë së Punëve të Brendshme (shih bashkëlidhur), ku thuhet në përgjigjen e tyre:

"Çdo OJQ e regjistruar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/22 për Regjistrimin dhe Veprimtarinë e Organizatave Joqeveritare në Kosovë konsiderohet e regjistruar në Kosovë sipas ligjit për OJQ, por që pas shpalljes së Pavarsisë së Republikës së Kosovës, OJQ duhet të ndrrojë Certifikatën me llogo të UNMIK-të në Certifikatën me llogo të Republikës së Kosovës". Që kjo nënkupton që Certifikata nuk është valide (Sikurse që pas Pavarësisë se Republikës se Kosovës qe eshtë kërkuar ndrrimi i të gjitha certifikatave te regjistrimit te biznesave ne ARBK, që për nos ndryshimin e tyre OE janë shpallur të pa pergjegjshëm).

Ne anën tjetër, ne është mohuar e drejta e prezentimit se OJQ ve ta tjera pasi qe te **"Përshtatshmëria Profesionale"** nuk kërkohet që mund te marin pjesë edhe OJQ-te. Ju perkujtojme që sikur te ishte kërkesë e tillë edhe ne do te bynim ne konsorcium me një OJQ sepse ju perkujtojme që OJQ te jane organizata jo-fitimprurëse dhe që nuk paguajne Tatim ne Fitim, kjo është edhe arsyeja e diskriminimit qe na u është bërë sepse nuk jemi te barabarte ne raport me ATK-ne, perderisa biznesat e regjistruara ne ARBK paguajnë tatim fitim dhe nuk kane lehtesina te tjera sikurse OJQ te. Thenit se jemi diskriminuar per arsye se sikur ne te diniim se mund te aplikojn edhe

"ESG" N.P.SH
Numri Unik Identifikues:
811284302
Email:
esg.npsh@gmail.com

OIQ-të, (përderisa një gjë e tillë nuk është rregullar/njoftuar tek shapllja e tenderit) ne do të aplikonim me OIQ-të që janë bazohemi me kundërshtarët dhe te kemi edhe ne mundësi të dalim me një emër të paraqesh me një OIQ pa u dënuar për shkak të obligimeve tatimore dhe arsyeve të lartpërmbajtura. Andaj bazuar në shpalljen e tenderit ne nuk kemi pas informatës qe mund të aplikon edhe një OIQ dhe me këtë rast në mënyrë direkte jemi të ne lajthitje duke u dënuar dhe sjell vetvetën në një pozitë aspak të barabartë si pasoj e veprimeve e mosveprimeve të AK.

Prandaj, konform FDT OE i shpallur fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm sepse nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe sipas Nenit 59 pika 4.

II. Grupit të OE-ve i **mungon Certifika e Licencimit si Person Juridik.** Operatori ekonomik duhet të plotësoj kriteret e veçanta ne përputhje me nenin 10 te Ligjit për Sherbime Keshillimore 04/L-074. Kjo nuk figuron as te lidhja e ofertës.

Jemi pajtuar që LPP neni 66 ka mundësuar që O.E KDC & GLV - Gjeravica të i kërkojnë sqarime shtesë për licencën e ushtrimit te veprimtarisë keshilluese të lëshuar nga MBPZHR/DSHKT-së.

III. Grupit të OE-ve nuk i plotëson kriteret teknike profesionale sipas pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së ku kërkohet te pika 2. tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhinier te diplomuar me këto profile: **1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore 2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale 3. Ekspertë i pemëtarisë- vreshtarisë.**

3.1. Sipas listës së stafit **Avni Kasumaj** figuron që do të angazhohet Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale. **Në bazë të dëshmive të cilat i kemi siguruar z.Avni Kasumaj i mungon diploma dhe përvoja në fushën e prodhimtarisë blegtorale.** Avni Kasumaj ka dorëzuar një certifikatë të viti 1986 ku nuk shkruan profili i saktë se në cilën fushë ka diplomuar dhe gjithashtu në CV dhe referenca nuk i figuron askund si një punë e vetme që ka punuar si ekspert i prodhimtarisë blegtorale.

Ju lutem që ti referoheni LPP-së: **Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njëkohësisht me gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

4. Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; ne veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen: 4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, ne veçanti, te personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; 4.2. listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore te rëndësishme te shërbimeve te realizoara ne periudhën e shkuar treviçeçare, duke saktesuar llojin e shërbimeve te

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH. ESG - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese"** me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

perfshirë shumën e kontratës, datën dhë pranësinë; ii) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë (sic në vendin tjetër), si dëshmi për kërkesën e sigurimit të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar nga bashkëngushkruesi nga autoriteti i tillë publik; iii) kur shërbimet janë siguruar per blerësin privat, deshmi per kerkesën e sigurimit te sherbimeve duhet te jete kopja e cdo dokumenti te nenshkruar nga bleresi dhe evidentuar i sigurimit te tille;

Kjo nënkupton në këtë rast për OE që nëse CV-ja e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm sipas LPP Neni 69.

Nuk është e mjaftueshme vetëm dëgjimi i CV dhe referencave. Por, duhet që ta jetë konform kërkesave minimale teknike profesionale sipas pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së.

Ju lutem referojuni CV dhe referencave të z. Avni Kasumaj, përvoja ka të bëj me Udhëheqje si drejtor ekzekutiv, koordinator i projektit, kontrollor, lider i projektit dhe zyrtar i projekteve ku në cv askund nuk përmendet që ka përvojë si ekspert i blegtorisë. Ju e dini dallimin në mes të ekspertit të fushës kur kërkohet, dhe menaxhimit të projekteve. Gjithashtu, në asnjë vend të vetëm as në referenca dhe as në CV blegtoria nuk përmendet në një vend të vetëm.

3.1. Z. Ismet Isufi, CV e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat, në asnjë vend të vetëm nuk shkruan që ka përvojë si ekspert i prodhimtarisë bimore. Edhe pse CV ne gjuhën angleze ju lutem shikoni që në asnjë vend të vetëm nuk përmendet termi Plant Production (që nënkupton prodhimtarinë bimore). Gjithashtu, Ismet Isufi është inxhinier i diplomuar i bujqësisë, pa specializim të veçantë sipas pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së. Ne bazë të CV z. Isufi ka përvojë në prodhimtarinë e qumështit dhe sistemit të ujitjes së tokave dhe në teknologjinë e prodhimit të dubanit, qe dallon shumë nga eksperienca e prodhimtarisë bimore, qe i mungon në CV. (Për shkak të qasjes së vonshme nuk kemi arritur që këtë pike ta atakojmë ne kerkesën per risbqyrtim ne AK), prandaj gatë analizës e basem edhe këtë shkelje ligjore të AK).

Ju lutem referojuni fillimit të CV së z. Ismet Isufi ku tregon që ka përvojë 28 vjeçare si ekspert në fushën e menaxhimit, menaxhimit të bujqësisë, financave dhe buxhetit, hidro-inxhinierisë dhe ujitjes.

Prandaj, në këtë rast AK është dashur që nëse CV-ja e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm sipas LPP Neni 69.

3.2. Z. Rexhep Alija edhe pse i diplomuar në degën Peneta-vreshtari, **nuk figuron në referenca që ka punuar si ekspert i pemëtarisë dhe vreshtarisë**. Evidentimi i punëve ne CV nuk eshte argumentuar permes CV-se. Ne cv shkruan vetëm që ka punuar si ekspert bujqësor pa specifikuar fushën e ekspertizës. Gjithashtu, ne referencë shkruan që "Angazhimi i tij ka përfshirë me hartimin e planeve te punës për ofrimin e këshillave praktike: Ofrimin e ndihmës teknoko logjistike për implementimin e trajnimeve dhe sherbimeve këshilluese në komunat sipas planit dinamik; aktivitet për ngritjen e kapaciteteve për fermerë dhë shoqata të fermerëve; mbikëqyrjen e realizimit të aktiviteteve. Nuk figuron askund që z. Rexhep Alija ka përvojë si ekspert **i pemëtarisë dhe vreshtarisë.**

"ESG" N.P.SH
Numri Unik Identifikues:
[illegible]
Email:
esgupsh@gmail.com

3.3. Z. **Feim Salihu** në listën e stafit figuron si Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale, i mungon përvoja e punës si ekspertë i prodhimtarisë blegtorale, **nuk figuron askund në CV dhe në referencë.**

Kjo nënkupton në këtë rast për OE që nëse CV-ja e dorëzuar nuk i përmbush kërkesat, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm sipas LPP Neni 69.

Nuk është e mjaftueshme vetëm dergimi i CV dhe referencave. Por, duhet që të jete konform kërkesave minimale teknike profesionale sipas pikës 9.1 & 9.2 te FDT-së.

Ju lutem referojuni CV dhe referencave të z. Feim Salihu, përvoja ka të bëj me Udhëheqje si drejtor dhe menaxhim, në cv askund nuk përmendet që ka përvojë si ekspert i blegtorisë. Gjithashtu, në asnjë vend të vetëm as në referenca dhe as në CV blegtoria nuk përmendet në një vend të vetëm.

Si konkludim mund të themi në bazë të dëshmive të cilat OE i ka dorëzuar per **Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** sipas pikës 9.1 & 9.2 të FDT-së nuk i plotëson kriteret minimale teknike sipas LPP se, **Neni 69.**

Ju lutem që ta rishikoni dosjen e tenderit të dorëzuar nga OE dhe ta lexoni në detaje sidomos pjesën e CV dhe referencave të ekspertëve.

Ju falemnderit për mirëkuptimin.

Me respekt,

Fkrem Sadiku, Drejtor

Apolona Syla, Avokat

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: a.Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04L-042,Neni 65.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit,Anekesi 2(Origjinal).
b. Një dokument nga Administrata Tatimore evendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).
c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Në rast të dështimit në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit ose (ARBK).	1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit-me shifrën e veprimtarisë përkatëse (kopje), për Kompanitë e huaja, në rast të shpërblimit me kontratë, duhet të regjistrojnë biznesin (përfaqësinë) e tyre në Kosovë.
2.Certifikata e TVSH-së, për kompanitë vendore.	2. Certifikata e TVSH-së (kopje).
3.Certifikatën me numër fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës- për kompanitë vendore.	3. Certifikatën me numër fiskal (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: 1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet te ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues së qarkullimi vjetor i OE së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak se 588,200.00€.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për periudhën e shkuar trevjeçare.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori ekonomik duhet të plotësoj kriteret e veçanta ne përputhje me nenin 10 te Ligjit për Sherbime Keshillimore 04 L.074.	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* 1. Personi juridik që ofron shërbime Këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të financuara nga fondet publike apo fondet ndërkombëtare, duhet të 1.1. posedoj lejen e punës; dhe 1.2. të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural në Ministri. 2. Personi juridik sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet plotësoj kriteret si në vijim 2.1. të ketë të punësuar së paku dy (2) këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural që posedojnë certifikata valide sipas nenit 17. të këtij ligji; 2.2. të ketë hapësirë dhe pajisje të nevojshme për veprimtarinë këshilluese; 2.3. të ketë licencën për ushtrimin e veprimtarisë të shërbimeve këshilluese të lëshuar nga Ministria. 3. Personi Juridik që ofron shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të cilat nuk janë të ndërlidhura me fondet publike dhe ndërkombëtare, duhet të regjistrohet në Regjistrin e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
2.Operatori ekonomik duhet te kete staf të mjaftueshem për zbatimin e projektit ku përveq ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhiner te diplomuar me keto profile 1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore 2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtoriale 3. Ekspertë i pemëtarisë- vreshtarisë	2.Dëshmi Kontratë pune valide ose marrëveshje për ketë projekt, Diploma e fakultetit te Bujqësisë 4 vjeçar ose ekujvalent me master, CV, letër rekomandime ose referenca për punën e mëparshme-kopje
3.Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak se 441.150.00euro (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare).	3. Lista e projekteve të realizuara origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kerkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare),duke bashkëngjitur referenc ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projektit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/ Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	z.Blerim Hasani – Sekretar i Përgjithshm i MBPZHR-së
CC:	z.Fatmir Istrefi – Zv. Shef i Divizionit të Prokurimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

NGA/OD/FROM:		Sami Osmani – Kryesues i komisionit			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		**Ekstrakt i procesverbalit të Komisionit për vlerësimin e ofertave** *„Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese"*			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:		Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	06.10.2022
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☒
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☐
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☐
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☐
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuar,

Duke u bazuar në Vendimin e ZSP të datës 02.09.2022 me numër të REF.ZSP-476/22, Nr302 për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për procedurën e tenderimit *„Zhvillimi I zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese"* komisioni në përbërje:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese"** me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

1. Sami Osmani - Kryesues
2. Hasan Sejfijaj - Anëtar
3. Marjan Karrica- Anëtar

Sipas vendimit të lartëpermendur, komisioni në përbërje të plotë menjëherë ka filluar punën.

Komisioni sipas pikës 2, 3 dhe 4 të vendimit, Ligjit Prokurimit Publik dhe Rregullores mbi prokurimin publik ka vlerësuar kushtet formale administrative të pjesëmarrësve në tender për ofertat e tre (3) OE/Konzorciumeve që kanë aplikuar për *„Zhvillimi I zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese"*. Duke u bazuar në kërkesat e AK kemi përdorur sistemin e e-prokurimit online për pranimin e dosjes së tenderit ku komisioni ka vlerësuar ofertat si në vijim:

I. Gjatë egzaminimit të ofertës së dorëzuar nga Konzorciumi **OJQ. KDC & GLV "Gjeravica"** kemi konstatuar:

1. **Kërkesat e përshtatshmërisë:**
   1.1. Një deklaratë e shkruar nën Betim – **është në dosje**
   1.2. Vërtetimin nga Administrata Tatimore - **është në dosje** (duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues) -
   1.3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, - **nuk është në dosje**
2. **Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:**
   2.1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit – **është në dosje**
   2.2. Certifikata e TVSH-së (kopje) – **është në dosje**
   2.3. Certifikatën me numër fiskal (kopje) – **është në dosje**
3. **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare**
   3.1. Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues së qarkullimi vjetor i OE së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak se 588,200.00€ - **e plotëson kriterin**
4. **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale**
   4.1. Operatori ekonomik duhet të plotësoj kriteret e veçanta ne përputhje me nenin 10 te Ligjit për Sherbime Keshillimore 04 L074
      4.1.1. Të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural në Ministri – **është i rigjistuar**
      4.1.2. Të ketë të punësuar së paku dy (2) këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural që posedojnë certifikata valide - **e plotëson kriterin**

4.1.3. Të ketë licencën për ushtrimin e veprimtarisë të shërbimeve këshilluese të lëshuar nga Ministria – *(është kërkuar nga AK (me datë-21.09.2022) duke u bazuar nenin 66 të ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës të cilën OE e ka sjellur)* - **e plotëson kriterin**

4.2. Operatori ekonomik duhet te ketë staf të mjaftueshëm për zbatimin e projektit ku përveç ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhinier te diplomuar me këto profile

4.2.1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore - **e plotëson kriterin**

4.2.2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtoriale - **e plotëson kriterin**

4.2.3. Ekspertë i pemëtarisë- vreshtarisë - **e plotëson kriterin**

4.3. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 441,150.00euro (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) - **e plotëson kriterin**

5. Sigurimit të Tenderit - **është në dosje**
6. Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - **Specifikimet teknike me përshkrimin e çmimeve nga OE/Konzorciumi - është në dosje**

Komisioni konstaton se OE/Konzorcium i ka përmbushur kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit, prandaj për komisionin ky është i përgjegjëshëm.

II. Gjatë egzaminimit të ofertës së dorëzuar nga OE N.T.Sh."ESG" *komisioni konstaton i ka përmbushur kërkesat minimale sipas dosjes së tenderit, ky OE është i përgjegjëshëm.*

1. **Kërkesat e përshtatshmërisë:**
   1.1. Një deklaratë e shkruar nën Betim – **është në dosje**
   1.2. Vërtetimin nga Administrata Tatimore - e posedon (duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues) - **është në dosje**
   1.3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore- Departamenti për Çështje Ekonomike - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, - **është në dosje**
2. **Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:**
   1.1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit – **është në dosje**
   1.2. Certifikata e TVSH-së (kopje) - **është në dosje**
   1.3. Certifikatën me numër fiskal (kopje) - **është në dosje**
3. **Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare**
   1.1. Operatori ekonomik duhet te ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues së qarkullimi vjetor i OE së për periudhën e shkuar trevjeçare ka qene jo me pak se 588,200.00€ - **e plotëson kriterin**
4. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

4.1. Operatori ekonomik duhet të plotësoj kriteret e veçanta ne përputhje me nenin 10 te Ligjit për Sherbime Keshillimore 04 L074.

4.1.1. Të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural në Ministri – **është i rigjistuar**

4.1.2. Të ketë të punësuar së paku dy (2) këshilltarë për bujqësi dhe zhvillim rural që posedojnë certifikata valide – *Konzorciumi e ka deshmuar se e ka vetëm një (1) këshilltarë të certifikuar me certifikatë valide* – **nuk e plotëson kriterin**

4.1.3. Të ketë licencën për ushtrimin e veprimtarisë të shërbimeve këshilluese të lëshuar nga Ministria - **e plotëson kriterin**

4.2. Operatori ekonomik duhet te ketë staf të mjaftueshëm për zbatimin e projektit ku përveç ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhinier te diplomuar me këto profile

4.2.1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore - **e plotëson kriterin**

4.2.2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtoriale – **nuk e plotëson kriterin**

4.2.3. Ekspertë i pemëtarisë- vreshtarisë - **e plotëson kriterin**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

6.1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses projekte të natyrës së ngjashme të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 441,150.00euro (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) - *Konzorciumi i ka ofruar listën e projekteve por nuk ka mundur të dëshojë sipas pikës 3 me referenca apo procesverbale e pranimit përfundimtarë për projektet e realizuar. Ndërsa referencat e ofruara i ka jashtë afatit trevjeçare sipas dosjes së tenderit* - nuk e plotëson kriterin

5. Sigurimit të Tenderit - **është në dosje**
6. Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME- **Specifikimet teknike me përshkrimin e çmimeve nga OE/Konzorciumi - është në dosje**

Komisoni konstaton se nga tre (3) OE/Konzorciumet në këtë tender, dy(2) OE/Konzorciumet: OJQ. KDC & GLV "Geravica" dhe N.P.Sh. "ESG" *i kanë plotësuar kërkesat minimale të kualifikimit të kërkuar sipas dosjes së tenderit dhe janë të përgjegjëshem,* ndërsa një (1) OE/ Konzorcium ("Policy And Management Consulting" SHPK & "Business Support Centre Kosovo" & "Proed" SHPK) *nuk i ka plotësuar kërkesat minimale të kualifikimit të kërkuar sipas dosjes së tenderit dhe është i papërgjegjëshem.*
Komisoni konstaton se OE/Konzorcium **OJQ. KDC & GLV "Geravica"** është i përgjegjëshem dhe me ofertën e çmimit më të lirë, ku në bazë ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës përcaktohet se ofertuesi më i lirë duhet të shpërblehet me kontratë.

1. Sami Osmani – Kryesues _____
2. Hasan Sejfijaj - Anëtar _____
3. Marjan Karrica - Anëtar _____

Me respekt

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Me dt.08.12.2022 permes emaili kam kërkuar sqarime shtesë nga autoriteti kontraktues si me poshtë:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

I nderuari z. Aliaj,

Shpresoj të jeni mirë dhe punët të ju shkojnë mbarë.

Jam Faruk Rexhaj, i autorizuar ne cilësinë e ekspertit te jashtëm nga ana e OSHP-së ne lenden 662/22 me numër te prokurimit: 203-22-7378-2-1-1.

Gjatë analizimit te lendes ne fjalë, ne platformën e EPROKURIMIT, keni te ngritur dosjen e tenderit: Servisim dhe Mirëmbajtje Automjeteve, nuk është dosja për të cilën behet fjalë.

Ju lutem shikoni nëse keni mundësi ta përmirësoni ne platformë apo edhe të me dërgoni dosjen finale ne këtë email.

Po ashtu një faill ne ofertën e grupit te operatoreve ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik OJQ KDC GJ; GLV Gjeravica, nuk po krijon mundësin e hapjes, nëse nuk e keni shumë problem mi dërgoni te skanuara dokumentacionin e eksperteve te paraparë ne Kapaciteti teknik dhe profesional konkretisht kërkesat e parapara ne piken 2. te njoftimit për kontratë.

Te bashkangjitur gjeni autorizimin nga OSHP.

Me nderime,

Faruk Rexhaj

Me dt. 09.12.2022 kem pranuar përgjigjejen dhe dokumentacionin e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues si me poshtë:

I nderuar,
Pas pranimit të email-it nga z. Aliaj lidhur me kërkesën e juaj për dokumentacionin e kërkuar, ju dërgojmë të kompletuar dosjen e tenderit për projektin "Zhvillimi I zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshilluese".
Gjeni të bashkangjitur dosjen e tenderit dhe dokumentacionin e ekspertëve të OE : Group i OE OJQ KDC GJ; GLV Gjeravica.

Për qdo paqartësi ju lutem na shkruani.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatori ekonomik është palë me interes ne këtë procedurë te prokurimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese**" me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë rast nuk ka pas ndonjë shqyrtim me herët, ne përjashtim te kërkesës për rishqyrtim nga ana e autoritetit kontraktues.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Nuk shoh ndonjë devijim

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.P.SH "ESG" PRISHTINË

Përgjigjeje ne pretendimet ankimore

Pretendimet ankimore te Operatorit Ekonomik Ankues qëndrojnë pjesërisht, si ne vijim:

Pretendimi ankimor 1.

Përshtatshmëria profesionale

1.Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit ose (ARBK).

Në bazë të analizës se këtij te këtij pretendimi ankimor vërehet se Autoriteti Kontraktues ka bërë zbatim të gabuar të se drejtës materiale, konkretisht Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe Ligjit për Lirinë e Asocimit Nr.04/L-057.

I. Legjitimiteti i OJQ-së për tu kualifikuar si operator ekonomik

- Fillimisht duhet cekur se jo çdo OJQ është organizatë e shoqërisë civile. Mungon analizimi i kësaj pjese nga autoriteti kontraktues, sepse nuk është sqaruar dhe argumentuar se OJQ ne fjalë hyn në kuadër të përkufizimit të përcaktuar në ligj për prokurimin publik. Duhet analizuar statuti dhe certifikata e regjistrimit te OJQ-së në fjalë, për te kuptuar nëse e njëjta ka mandat te një organizate te shoqërisë civile.

- Autoriteti kontraktues nuk mund ta autorizoje një OJQ qe te kryej veprimtari afariste dhe fitimprurëse, pa marr paraprakisht parasysh specifikat dhe fushëveprimin e një organizate të tillë.

II. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së

OJQ-ja në fjalë ka deponuar një certifikatë regjistrimi të lëshuar nga UNMIKU edhe përkundër faktit se tashme Republika Kosovës ka institucionet e saja për lëshimin e certifikatave te regjistrimit. OJQ-ja ka qenë e obliguar

që ta ndryshoje certifikatën e regjistrimit në mënyrë qe ajo te jetë në pajtim me legjislacion në fuqi. Nuk mund te konsiderohet valide një certifikatë e cila është lëshuar nga një administratë e përkohshme siç ka qenë UNMIK dhe se një certifikatë e tillë është dashtë te përditësohet dhe t'i përmbaj te gjitha elementet e një dokumenti zyrtar te cilën e lëshojnë institucionet e Republikës së Kosovës, duke filluar nga autoriteti kompetentë, logoja dhe elementet tjera konstituive te një dokumenti zyrtar.

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike Nr. Nr. 03/L-215, konkretisht neni 3 pika 1.3 përcaktohet se dokumentet zyrtare janë ato dokumente të lëshuara nga institucionet publike. Institucione publike janë vetëm ato të cilat janë themeluar nga Republika e Kosovës dhe veprojnë në bazë të Kushtetutës se Republikës se Kosovës dhe ligjeve në fuqi. Duke u bazuar në këtë fakt një dokument i lëshuar nga UNMIK nuk mund të konsiderohet valide dhe si i tillë nuk mund të merret si bazë për vendimmarrje, për faktin së që nga shpallja e pavarësisë se Kosovës dhe themelimi i institucioneve vendore dokumentet duhet të lëshohen vetëm nga institucionet vendore.

Krahas sqarimeve te elaboruara me lart operatorit ekonomik ankues me dt. 08.11.2022 me një pyetje i është drejtuar ministrisë përkatëse , me pyetjen si ne vazhdim:

11/15/22, 2:25 PM Gmail - Kërkesë

Gmail

Ekrem Sadiku <esg.npsh@gmail.com>

Kërkesë
2 messages

ESG <esg.npsh@gmail.com> Tue, Nov 8, 2022 at 10:33 AM
To: Ibadete Ibriqi@rks-gov.net
Cc: Agim Zuzaku <azuzaku@gmail.com>, Ekrem Sadiku <ekrem@es-bs.com>

E nderuara Znj. Ibriqi,
Ju lutem nese mundemi te na njoftoni se a janë valide Certifikatat e UNMIK te OJQ-se, te cilat janë regjistruar sipas rregulores 1999/22
A kane keto Certifikata validitet?

Best Regards
Agim Zuzaku
Project Manager
ESG
Tel: [illegible]
E-mail: azuzaku@gmail.com
npsh.esg@gmail.com

Ibadete Ibriqi <Ibadete.Ibriqi@rks-gov.net> Tue, Nov 8, 2022 at 1:49 PM
To: ESG <esg.npsh@gmail.com>
Cc: "Bajram E.Kosumi" <Bajram.E.Kosumi@rks-gov.net>

I nderuar,

Çdo OJQ e regjistruar sipas Rregulores se UNMIK-ut nr.1999/22 per Regjistrimin dhe Veprimtarine e Organizatave Joqeveritare ne Kosove konsiderohet e regjistruar ne Kosove sipas ligjit per OJQ, por qe pas shpalljes se Pavarsise se Republikes se Kosovës, OJQ duhet te ndrroje Certifikaten me llogo te UNMIK-ës ne Certifikaten me llogo te Republikes se Kosovës.

https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=0eac2ca810&view=pt&search=all&permmsgid=msg-f%3A1745934934937439805&simpl=msg-f%3A1745934934937439805&mb=1&rapid=1&ogbl&ogsc&ogpv&ogmb&ogrc&ogsr&ogsb&ogpf&ogms&ogms&ogms

Pretendimi ankimor II Neni 69 Aftësia Teknike dhe ose profesionale

Ne bazë te analizës se këtij pretendimi nga ana e ekspertit dhe kritereve te parapara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë ku konkretisht thuhet se:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatori ekonomik duhet te këtë staf të mjaftueshëm për zbatimin e projektit ku përveç ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhiner te diplomuar me këto profile 1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore 2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale 3. Ekspertë i pemëtarisë-vreshtarisë.

Dëshmi te dokumentuara

Dëshmi Kontratë pune valide ose marrëveshje për ketë projekt, Diploma e fakultetit te Bujqësisë 4 vjeçar ose ekuivalent me master, CV, letër rekomandime ose referenca për punën e mëparshme-kopje.

Sipas analizës se bërë nga eksperti shqyrtues i lendes, operatori ekonomik i rekomanduar nga ana e autoritetit kontraktues si i suksesshëm, ka dështuar të ofroj dëshmi te mjaftueshme lidhur me Ekspertin e Prodhimtarisë Blegtorale (Eksperti posedon diplomë inxhinier i diplomuar ne fakultetin e bujqësisë, mirëpo i mungon profili ne lëmin e blegtorisë), ndërsa ka plotësuar kërkesat e ekspertit te Pemëtarisë e Vreshtarisë dhe kërkesën për ekspert të prodhimtarisë bimore.

Ky pretendim ankimor konsiderohet pjesërisht si i bazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:
- Ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e **BAZUAR,**
- Të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues
- Lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - N.P.SH "ESG" PRISHTINË

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH."ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese"** me nr. të prokurimit: **203-22-7378-2-1-1 dhe nr. Te brendshëm: 203-22-10-211**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.**